



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni pranveror**

Komisioni Ad-hoc për përpilimin e Kodit për rregullimin dhe menaxhimin e fushës së pensioneve dhe beneficioneve nga sigurimi social.

Mbledhja nr. 1

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 204

Prishtinë, më 19.3. 2019, në orën 10:00

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Dardan Sejdiu, Blerim Kuçi, Safete Hadërgjonaj, Flora Brovina, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

**Pjesëmarrës tjerë:** Shpresë Haxhijaj, koordinatore e Komisionit, Alberta Hyseni -KDI, Nora Kelmendi - Ekonomia Online, Shpresa Sejdiu-GP/PSD dhe Drita Vitia-Radio Kosova.

**Mbledhjen e kryesoi,** Dardan Sejdiu, kryetar i Komisionit.

**RENDI I DITËS:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Konstituimi i komisionit;**
- 3. Diskutim lidhur me Planit e punës së Komisionit;**
- 4. Të ndryshme.**

**1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

**2. Konstituimi i komisionit;**

**Dardan Sejdiu,** pasi i informoi se anëtarët e nominuar për këtë Komision nga subjektet politike janë këtu, shtopi se ende nuk kemi nominim nga subjektet LDK, VV dhe nga Lista serbe. Këto tri subjekte nuk i kanë nominuar anëtarët për këtë Komision Ad- hoc. I lusim që në afat sa më të shpejt t'i nominojnë edhe anëtarët e tjerë.

Pasi kemi prezent numrin e nevojshëm të anëtarëve, mund ta konsiderojmë të konstituuar këtë komision.

### **3. Diskutim lidhur me Planit e punës së Komisionit;**

**Dardan Sejdiu**, propozoi që të ketë një plan pune në dy faza. Në fazën e parë, tha do të kemi takime konsultative me palët e interesit dhe propozoi që takimi i parë të mbahet me ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Skender Reçica. Ministria e Punës ka përgatitur një koncept dokument për reformën e skemave pensionale, për të cilin do t'na informojë ministri. Gjithashtu, do ta ftojme edhe ministrin e financave z. Bedri Hamza .

Sejdiu propozoi takime edhe me grupet e interesit dhe palët e interesuara në temën e pensioneve dhe sigurimeve sociale. Pra, në fazën e parë, propozoi takime me palët e propozuara, në mënyrë që të sigurohen informacionet e nevojshme për procesin.

Ju informoj, shtoi Sejdiu, se më kanë kontaktuar përfaqësues të Fondit Monetar Ndërkombëtar, përfaqësues të Bankës Botërore dhe përfaqësues të organizatave të ndryshme, që janë të angazhuar në temën e çështjeve sociale dhe janë të gatshëm që të na ndihmojnë me ekspertizë teknike, kurse kemi edhe një takim me disa përfaqësues të BB-së javën e ardhshme.

**Flora Brovina**, tha se para takimit me ekspertët e Bankës Botërore, do ishte mirë të kemi një takim me drejtorin e sistemit pensional brenda Ministri së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe të njoftohemi me procesin si ka rrjedhur deri më tani, ta kemi edhe koncept dokumentin që është punuar në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

**Dardan Sejdiu**, theksoi se do t'ju përgatisim dokumentet e nevojshme për punë, pastaj pjesa e parë e punës së Komisionit të jetë në takime dhe konsultime, ndërsa pjesa e dytë jetë për nxjerrjen e rekomandimeve konkrete, të cilat mund të shndërrohen edhe në raport të Komisionit.

**Safete Hadergjonaj**, tha se çështja e pensioneve është çështje e ndjeshme dhe shumë e rëndësishme për qytetarët dhe më vjen keq që kolegët tonë deputetë nuk janë bërë pjesë e këtij Komisioni. Grupet parlamentare kur i caktojnë deputetët për të marrë pjesë në këtë komision e kanë parasysh t'i caktojnë ata deputetë që e njohin problematikën e pensioneve dhe i qasen më me seriozitet kësaj pune.

Më vjen mirë që kemi takim me ekspertë të Bankës Botërore dhe mendoj që duhet ta caktojmë edhe një takim me përfaqësues të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe t'i kemi edhe komentet e tyre dhe pasi t'i realizojmë të gjitha takimet dhe t'i kemi informatat e nevojshme, do ta kemi një koncept të qartë se si t'i qasemi kërkesave të qytetarëve dhe ta fusim këtë koncept në sistem.

**Blerim Kuqi**, tha se pasi është takimi i parë, të diskutojmë për planin, por duhet ta aprovojmë sa më shpejt planin e punës dhe ta zëmë afatin kohor, në mënyrë që t'a përfundojmë punën.

**Enver Hoti**, tha se si Komision duhet ta caktojmë një ditë të javës ku do t'i mbajmë takimet e rregullta, në mënyrë që mos të kemi mungesë të kuorunit.

**Dardan Sejdiu**: Sot do t'jua dorëzojë disa dokumente që i kam në dispozicion dhe të përgatitemi edhe për takimin me Bankën Botërore. Javën që vjen do t'i mbajmë takimet me ministrat dhe do ta miratojmë edhe planin e punës.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

**Kryetar i Komisionit,**

**E përgatiti:**

**Stafi mbështetës i Komisionit.**

---

**Dardan Sejdiu**